



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 6, 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, neneve 11, 12 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe neneve 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozimit të Vendimit të Kryetarit miratojë këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BANULLË

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh personave fizik dhe juridik paluajtshmëria që gjendet në zonën kadastrale Banullë në ngastrën kadastrale P-71409003-00926-0 në vendin e quajtur “Rosula” me kulturë me arë e kl.4-të me sipërfaqe prej 28018m² e evidentuar në Certifikatën nr.172/2016 ZK Banullë në pronësi të Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së komunës është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 3

Sipas nenit 1 të këtij vendimi prona ipet në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet konkursit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Procedurën e konkursit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 15 Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, dhe Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatgjatë të regjistron në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim në periudhë afatgjatë.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-11845
Lipjan, më 04. 03. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajruni

